

VENDIM
Nr. 38, datë 23.2.2018

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN PËR
NDRYSHIMIN E FURNIZUESIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, MIRATUAR ME
VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 113, DATË 8.7.2016.**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.2.2018, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, mbi fillimin e procedurës për disa ndryshime në “Rregulloren për ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 113, datë 8.7.2016, ka vendosur të miratojë “Rregulloren për ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike”.

- Në datën 6.2.2018, në ERE ka mbërritur shkresa e shoqërisë OSHEE sh.a. me nr. 2312 prot. (protokolluar në ERE, me nr. 171, datë 12.2.2018), nëpërmjet së cilës OSHEE sh.a. kërkon nga ERE amendimin e dispozitave të kësaj rregulloreje, që kanë të bëjnë me lejin e abonentëve debitorë të ndryshojnë furnizuesin.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë OSHEE sh.a., për disa ndryshime në “Rregulloren për ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 113, datë 8.7.2016, si më poshtë:

a) Lejimin e klientëve debitorë të ndryshojnë furnizuesin në rast se debia merret përsipër nga furnizuesi i ri;

b) Lejimin e klientëve debitorë të ndryshojnë furnizuesin në rast se midis furnizuesit të mëparshëm dhe klientit ka një marrëveshje për likuidim të vonuar të debisë.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë dhe palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti